



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKË E KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 60/13

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data / Datum 28.03.2013

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.3 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të vendimit të KK-së 01 Nr.269/12, dt. 27.09.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **28.03.2013**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR SHTRUARJEN E RRUGËVE DHE TROTUAREVE ME KUBËZA BETONI PËR**  
**VITIN 2013**

**Neni 1**

Aprovohet shtruarja e rrugëve dhe trotuareve me kubëza betoni për vitin 2013.

1.1. Rrugët që do të shtrohen me kubëza betoni janë:

"2 Maji" Segmenti 1 dhe 2; "Ruzhdi Hyseni" (te mulliri); "Jeton Tërstena" segmenti 1,2,3,4; "Lutfi Musiqi" segment; "Faik Konica"; "Vëllezërit Frashëri"; "Hajzer Jashari"; "Haxhi Zeka" magjistrale-segment; "Zahir Pajaziti"; "Avni Saraçi"; "Hakif Zejnullahu" segmenti 1 dhe 2; "Kongresi i Manastirit" te shkolla "Ali Kelmendi"; "Shotë Galica" magjistrale-segmenti 1,2,3; "Bastri Beqiri"; "17 Qershori" segment; "Bahri Kuqi" segmenti 1, 2, 3, 4; "Skënderbeu" segmenti 1 dhe 2; "Izet Zejnullahu" kubëza, kanalizim dhe ujësjellës; "Shalës" segmenti 1, 2 dhe 3; fsh. Begaj segmenti 1 dhe 2; fsh. Bukosh segmenti 1 dhe 2; fsh. Shtitaricë segmenti 1, 2, 3; fsh. Gojbulë; fsh. Mihaliq lagjja "Syla"; "Faruk Beqiri" segmenti 1; "Drenica" segment; te Musa Balaj; fsh. Dobërllukë segment; fsh. Stanoc lagj. "Shala"; fsh. Nadakoc lagj. "Sahiti"; "Isak Halili" segment; "Edmond Hoxha"; "Faik Konica" te Shkolla e Mesme Teknike; "Milaim Salihu"; dhe Te Podrança te lagjja "Jonuzi".

1.2. Trotuaret që do të shtrohen me kubëza betoni janë:

"Ajet Gërguri" te ish-Poleti; Te ura e Sitnicës-Stacioni i Trenit – Bukosh; "2 Maji" deri te Njësia e Zjarrfiksave; "17 Qershori"; fsh. Begaj- vazhdim; fsh. Shtitaricë Hekurudhë-shkollë; "Bedri Pejani"; fsh. Bukosh, te shkolla para oborrit; "Lumni Surdulli"; "Isak Halili"; "Bahri Kuqi"; "Hazir Gjaka"; "Vëllezërit Gërvalla"; "Jeton Tërstena"; "Faruk Beqiri"; "Hakif Zejnullahu"; fsh. Lum Madh; në fsh. Dobërllukë "te qeshmja"; fsh. Smrekonicë te Përmendorja e Xhevat Jusufit; fsh. Stroc – në shf. "Liria"; fsh. Maxhunaj.

**Neni 2**

Përparësi në shtrimin e trotuareve dhe rrugëve me kubëza sipas nenit paraparak do të kenë ato komunitete që participojnë në përqindje më të madhe.


**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.3 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të kërkesës nr. 12/36, dt. 12.03.2013 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Mitrovicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **28.03.2013**, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR SHFRYTËZIMIN PA PAGESË TË PASLESTRËS SË SPORTEVE NGA KLUBET**  
**SPORTIVE TË MITROVICËS**

**Neni 1**

Me këtë vendim lejohet shfrytëzimi i palestrës së sporteve në Vushtrri nga klubet sportive të Mitrovicës për zhvillimin e ndeshjeve kampionale pa pagesë.

**Neni 2**

Lejimi i shfrytëzimit të palestrës së sporteve në Vushtrri sipas nenit paraprak, bëhet deri në finalizimin e renovimit të Palestrës Sportive "Minatori" në Mitrovicë.

**Neni 3**

Në rast të dëmtimit eventual të inventarit të palestrës gjatë zhvillimit të ndeshjeve sportive, organizatori do të kompensojë të gjitha shpenzimet për riparimin e dëmeve të shkaktuara.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Palestra e Sporteve "Jeton Tërstena" në Vushtrri.


**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

  
**Habib Mustafa**





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, si dhe nenit 48 "p" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 28.03.2013, mori këtë:

## **V E N D I M**

### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE**

#### **Neni 1**

**1.1.** Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve në këtë përbërje:

- 1.1.1.** Islam Latifi, zyrtar nga Drejtoria për Shërbime Publike;
- 1.1.2.** Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit;
- 1.1.3.** Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit.

#### **Neni 2**

Komisioni komunal i aksionarëve vepron në emër të komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Ndërmarrje Publike, si dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

#### **Neni 3**

Komisioni komunal i aksionarëve do të përgatit dhe nxjerr një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të komunës në lidhje me pronësinë dhe rolin e saj në qeverisjen dhe menaxhimin e stacionit të autobusëve. Kjo politikë e pronësisë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj.

#### **Neni 4**

Komisioni komunal i aksionarëve përfaqëson komunën në mbledhjen e aksionarëve dhe ushtron të drejtën e votimit në emër të komunës në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrje Publike.

#### **Neni 5**

- 5.1.** Komisioni i aksionarëve të komunës aksionare në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike e zgjedh bordin e drejtorëve, ku secili nga këta drejtorë do të ketë mandat prej 3 vjetëve.
- 5.2.** Drejtori i pestë është kryeshefi ekzekutiv dhe zgjedhet nga bordi i drejtorëve në përputhje me nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
- 5.3.** Bordi i drejtorëve, menjëherë pas zgjedhjes së tij, do ta zgjedh kryesuesin e këtij bordi.

#### **Neni 6**

Komisioni komunal i aksionarëve i përgjigjet kuvendit të komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj, dhe do t'i raportoj kuvendit të komunës në bazë vjetore mbi performancën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në

politikën e pronësisë, si dhe do të siguroj të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe kuvendit të komunës mbi mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjes.

**Neni 7**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe komisioni komunal i aksionarëve.

**Neni 8**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Habib Mustafa**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

Bl Nr. / Br 57/13

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data / Datum 28.03.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 35 të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale nr. 330/12, dt.27.12.2012, si dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **28.03.2013**, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **PËR LIRIMIN NGA PAGESA E PALESTRËS SPORTIVE PËR SHMT "LUTFI MUSIQI" PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim lirohet nga pagesa e tarifës komunale SHMT "Lutfi Musiqi" në Vushtrri për shfrytëzimin e palestrës sportive "Jeton Tërstena".

##### **Neni 2**

Lirimi nga pagesa bëhet për një termin brenda javës, kur nuk pengohen aktivitetet e klubeve të komunës, kurse si kompensim SHMT "Lutfi Musiqi" i ofron objektit të palestrës mirëmbajtjen e instalimit teknik dhe ujësjellësit.

##### **Neni 3**

Ky vendim është pjesë përbërëse e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale 01 Nr. 330/12, dt. 27.12.2012 dhe i bashkëngjitet në shtojcë.

##### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Arsim.

##### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**







REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	56/13
Nr. i fq. / Br. sh	-1-
Data / Datum	28.03.2013
VUSHTRRI - VUČITRN	



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të komunës nr.04/L-144, si dhe nenit 41 "ç" dhe nenit 86 të Statutit të Komunës, nenit 3.2 të Rregullores për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme komunale nr.19-1/2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **28.03.2013**, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR ME KOMPENSIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

##### **Neni 1**

Me qëllim të interesit publik të komunës, lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim e pronave të paluajtshme të komunës të listuara nga nr. rendor 1 deri 158, të bashkangjitura në shtojë të këtij vendimi, personave fizik dhe juridik në afat prej 1 deri 15 vite.

##### **Neni 2**

Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër do të zbatohet përmes konkurrencës së hapur – ankandet publike.

##### **Neni 3**

Kuvendi i Komunës formon komision vlerësues për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave për pronat që do të jepen në shfrytëzim.

##### **Neni 4**

Kryetar i komunës përcakton drejtorinë përgjegjëse e cila kujdeset për procedurën e ankandit dhe menaxhimin e kontratave pas lidhjes së tyre, konform rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

##### **Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Zyra Ligjore e Komunës dhe komisioni për vlerësim.

##### **Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 55/13

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 28.03.2013

VUSHTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **28.03.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Transparencë të Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Transparencë të Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 29.03.2013 dhe zgjatë deri më 16.04.2013.

#### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

#### **Neni 4**

Obligohet Zyra për Informim që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu ZI-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Prill 2013.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Habib Mustafa**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br. 54/13

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data / Datum 28.03.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **28.03.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Strategjia për Informim, Komunikim, dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Strategjia për Informim, Komunikim, dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 29.03.2013 dhe zgjatë deri më 16.04.2013.

#### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

#### **Neni 4**

Obligohet Zyra për Informim që si hartues dhe propozues i Draft-strategjisë në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu ZI-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-strategjisë në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Prill 2013.

#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**

